



|   |                    |
|---|--------------------|
| REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO |                    |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT                            |                    |
| AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE                               |                    |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY                                  |                    |
| Dep.  | Nr. Prot.          |
| Dep. 2-D/OPK  | Br. Prot.          |
| Nr. i faq.  | Prot No 01-3222/14 |
| Broj stranaica  | Data               |
| Nr. pages 02  | Datum              |
|   | Date 15-09-2014    |
| PRISHTINE   |                    |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.09.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2163/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z Shkelzen Hajdini, Drejtor për Buxhet dhe Financa në Kuvendin Komunal të Lipjanit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi qe nuk ushtron me funksion ne biznes privatë.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt te interesit me numër protokolli AKK-03-2163/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Shkelzen Hajdini, Drejtor për Buxhet dhe Financa në Kuvendin Komunal të Lipjanit.**

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Drejtor në Kuvendin Komunal të Lipjanit është duke ushtruar edhe funksion ne veprimtari private pra s i person i autorizuar ne një biznes privat, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situat paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 07.07.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Shkelzen Hajdini, Drejtor për Buxhet dhe Financa në Kuvendin Komunal të Lipjanit, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar që ti bëhet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë në takimin që është mbajtur me z. Hajdini, me datën 22.07.2014 e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrim të funksionit publik, ndërsa, z. Hajdini është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se në afat sa me të shpejt do të tërhiqet nga personi i autorizuar në kompaninë private edhe pse ai biznes nuk zhvillon aktivitet, dhe do bëjë ndryshimet e nevojshme që të shmanget nga situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Me datën 05.09.2014, z. Shkelzen Hajdini, ka sjell në Agjenci dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuara dhe se në biznesin privat me nr biznesi 70820552 dhe emër N.SH“INTELLIGENT BUSINESS SOLUTINOS IBS” - zyrtari në fjale nuk është me si person i autorizuar në këtë kompani pasi që ka emëruar një person si person të autorizuar në këtë biznes

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik me largimin e tij nga funksioni i personit të autorizuar në kompaninë private“N.SH“INTELLIGENT BUSINESS SOLUTINOS IBS”- ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

